

Fondacioni “Fridrih Ebert”, zyra në Maqedoninë e Veriut në bashkëpunim me Progres – Institutin për demokraci sociale i mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare “Olof Palme” dhe Fondacioni “Kalevi Sorsa” shpallin:

KONKURS për pjesëmarrës për Akademinë Politike për demokraci sociale në vitin 2020

Akademia politike është projekt arsimor, i dizajnuar si kurs dhe trajnim akademik. Detyra kryesore e Akademisë është t'i arsimojë dhe trajnojë individët që ndajnë vlerat social-demokrate dhe në jetën e tyre të përditshme ndikojnë në formimin e vendimeve politike në Maqedoninë e Veriut.

Akademia Politike do t'u ofrojë pjesëmarrësve njohuri teorike, por edhe aftësi praktike në fushën e sistemit politik, ideologjinë social-demokratike, menaxhimin politik dhe partiak dhe komunikimin politik dhe marrëdhëniet me publikun. Këto synime do të realizohen brenda katër ose pesë cikleve të seminareve tre-ditore me module nga fushat e mësipërme. Kushtet dhe afatet nuk mund të përcaktohen në këtë kohë për shkak të gjendjes së shkaktuar nga virusi COVID-19.

Kushte për pjesëmarrje

Të drejtën për të aplikuar për pjesëmarrje në Akademinë ka:

- 1.** çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- 2.** në moshë nga 20 deri 35 vjet,
- 3.** është i angazhuar ose dëshiron të jetë aktiv në jetën shoqërore dhe politike në Maqedoninë e Veriut,
- 4.** ndanë politikat social-demokratike, dhe vlerat ekonomike, sociale dhe shoqërore,
- 5.** ka njohuri themelore për shkencat dhe terminologjinë shoqërore
- 6.** ka njohuri të mira në gjuhën angleze

Dokumente të duhura për pjesëmarrje

- 1.** Biografi me të dhënat për kontakt
- 2.** Letër motivimi

Përzgjedhja e kandidatëve

Kandidatët do të përzgjidhen në bazë të arritjeve personale (përfshirë arsimin akademik, arsimin joformal, përvojën e punës dhe praktikën) të listuara në biografinë tuaj dhe në letrën motivuese, si dhe diversitetin etnik, fetar, gjinor, rajonal dhe social në Maqedoninë e Veriut. Të gjithë kandidatët e regjistruar do të njoftohen për rezultatet e përzgjedhjes, jo më vonë se 11 maj, viti 2020 me anë të postës elektronike. Me disa nga kandidatët e zgjedhur, mund të ketë nevojë për të zbatuar një intervistë. Dokumentet jo të plota nuk do të merren parasysh!

Dorëzimi i dokumenteve

Dokumentet për paraqitje duhet të dërgohen jo më vonë se **30 prill**, viti 2020 në postën elektronike: pa@progres.org.mk

